



Lajmet Operacionet

27/08/2021

Lezhë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Kallmeti”

Lezhë

Goditet një tjetër rast i mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit dhe municionit luftarak.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Kallmeti”, i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Lezhë.

Sekuestrohen 1 armë zjarri kallashnikov, një armë gjahu dhe municion luftarak, arrestohet në flagrancë poseduesi i tyre.

Në zbatim të planit të masave për evidentimin dhe ndëshkimin e personave që mbajnë armë zjarri pa leje, shërbimet e Komisarimit të Policisë Lezhë, bazuar në informacionet e siguruar në rugë operative, zhvilluan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “ Kallmeti”, në kuadër të të cilit u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

-M. Ll., banues në fshatin Kallmet, Lezhë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 1 armë zjarri automatik me 2 krehra, 1 armë gjahu dhe municion luftarak.

Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.



Share

Share

Share

Share

Email

◀ Selenicë, Vlorë – Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “Otima”

Poliçan – Procedohet penalisht 1 shtetas, për prerje të paligjshme të pyjeve ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)